



Qendra Tregtare Univers SHPK

Pasqyrat Financiare per vitin ushtrimor 2016
(se bashku me Raportin e Audituesit te Pavarur)

INDIVIDUALE

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR	3
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E PERFORMANCES	2
PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO	4
PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE	5
1 Informacion i pergjithshem	6
2 Baza e pergatitjes	6
3 Mjete monetare	9
4 Te drejta te arketueshme	10
5 Te tjera te arketueshme	10
6 Aktive afatgjata materiale te mbajtura per investim	11
7 Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore shendetesore	12
8 Te pagueshme per detyrime tatimore	12
9 Arketime ne avance per porosi	12
10 Kapitali i nenshkruar	13
11 Te ardhura nga aktiviteti kryesor	13
12 Te ardhura nga aktivitete te tjera	13
13 Shpenzime te personelit	13
14 Shpenzime te tjera te shfrytezimit	14
15 Tatimi mbi fitimin	14
16 Ngjarje pas dates se raportimit	15



BAKER TILLY ALBANIA

Rr.Themistokli Gemenji, Nr.2
Pall.Ambasador 1, 3-rd floor
Tirana
Albania

T: +355(0)42232726

office@bakertillyalbania.com
www.bakertillyalbania.com

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Qendra Tregtare Univers Shpk, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2016, pasqyrën e performances dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto, pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, duke përfshirë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabile.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale gjëndjen financiare të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2016, rezultatin financiar dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK") miratuar me Ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" në Shqipëri.

Baza për Opinion

Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNAs). Përgjegjësia jone sipas këtyre standardeve përshkruhet në vijim në seksionin e raportit tonë Përgjegjësia e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe i kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin 16 të pasqyrave financiare "ngjarje pas datës së raportimit", ku përshkruhen efektet e rivlerësimit të aktiveve afatgjata materiale të mbajtura për investim. Opinioni ynë nuk është modifikuar për këtë çështje.

Përgjegjësia e Drejtimit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK miratuar me Ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë nga mashtrimi apo pasaktësia.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar në kushtet e vijimësisë së biznesit, zbulimin, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me vijimësinë dhe përdorimin e bazës së vijimësisë të kontabilitetit, përveç rasteve kur drejtimi synon të likuideojë Shoqërinë ose të pushojë veprimtarinë, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër realiste përveç kesaj.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë dhënia e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë pa gabime materiale, qoftë nga mashtrimi apo pasaktësia, dhe dhënia e raportit të audituesve që përfshin opinionin tonë. Siguri e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk është një garanci që një kontroll i kryer në përputhje me SNA gjithmonë do të zbulojë një anomalë materiale, kur ajo ekziston. Anomalitë mund të lindin nga mashtrimi apo pasaktësia dhe konsiderohen si materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato pritet që të ndikojnë vendimet ekonomike të marra nga përdoruesit mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo pasaktësive, planifikojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit, që u përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi, që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për bazat e opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material, që vjen nga mashtrimi është më i lartë se ai që vjen nga gabimet, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, mospërfshirje të qëllimshme, keq paraqitje, apo tejkallim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit, që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të njesisë ekonomike.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shënimeve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga drejtimi të parimit të vijimësisë në kontabilitet dhe, duke u bazuar në evidencën e marrë gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose rrethanat që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi aftësinë e njesisë ekonomike për të vazhduar në kushtet e vijimësisë së biznesit. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit për paraqitjen e këtij informacioni në shënime shpjeguese të pasqyrave financiare ose, nëse keto shënime janë të papërshtatshme, për të modifikuar opinionin tonë.
- Në rastet e një misioni për auditimin e një grupi, marrim evidencë auditimi, që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënat financiare të njesive ekonomike ose aktiviteteve tregtare brenda grupit për të shprehur një opinion për pasqyrat financiare të grupit. Ne jemi përgjegjës për drejtimin, mbikqyrjen dhe cilësinë e auditimit të grupit. Ne jemi të vetmit përgjegjës për opinionin e auditimit.

Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarje ose rrethana në të ardhmen mund të detyrojnë njesinë ekonomike të mos vazhdojë më në kushtet e vijimësisë së biznesit.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje në lidhje me, midis çështjeve të tjera, qëllimin e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Midis çështjeve që ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë, nëse ka, ato çështje që kanë qënë më të rëndësishmet për auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe rrjedhimisht janë çështje kryesore auditimi. Ne i përshkruajmë keto çështje në raportin tonë të auditimit përveç rasteve kur ligjet apo rregulloret e ndalojnë paraqitjen publike të çështjes ose kur, në raste shumë të rralla, ne vendosim që një çështje nuk duhet komunikuar në raportin tonë të auditimit sepse ndikimi negativ që do kishte, do të tejkallonte mjaftueshëm përfitimet e interesit publik të këtij komunikimi.

Baker Tilly Albania shpk.

Elton Haxhi

Auditues Ligjor

Tiranë

29 Mars 2017

Qendra Tregtare Univers Shpk
Per vitin e mbyllur ne 31 dhjetor 2016

(Vlerat ne Leke)

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

	Shenime	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	3	51.713.681	96.598.710
Te drejta te arketueshme	4	20.886.133	2.422.961
Te drejta te arketueshme nga njesite ekonomike brenda grupit		76.768.442	58.417.335
Te tjera te arketueshme	5	266.668.316	212.143.754
Inventaret		127.302	127.301
Te arketueshme nga te ardhurat e konstatuara		5.059.165	-
Totali i aktiveve afatshkurtra		421.223.039	369.710.062
Aktive afatgjate			
Aktive afatgjate materiale te mbajtura per investim	6	1.063.544.953	1.108.453.693
Totali i aktiveve afatgjate		1.063.544.953	1.108.453.693
TOTALI I AKTIVEVE		1.484.767.992	1.478.163.755
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Detyrime afatshkurtra			
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit		2.349.663	3.984.605
Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit		24.825.135	48.713.260
Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetsore	7	23.278	51.448
Te pagueshme per detyrime tatimore	8	18.622.468	43.289.133
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		5.060.214	2.552.678
Totali i detyrimeve afatshkurtra		50.880.758	98.591.124
Detyrime afatgjate			
Aktetime ne avance per porosi	9	6.524.122	4.602.085
Totali i detyrimeve afatgjate		6.524.122	4.602.085
Detyrime totale		57.404.880	103.193.209
Kapitali dhe rezervat			
Kapitali i nenshkuar	10	1.110.523.000	1.110.523.000
Fitimi i vitit		316.840.112	264.447.546
Totali i kapitalit		1.427.363.112	1.374.970.546
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		1.484.767.992	1.478.163.755

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 6 deri 15 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Keto pasqyra financiare jane pergatitur nga dhe miratuar ne 28 Mars 2017 nga:

Pergatiti:
 Yllka Bengu
 Financiere



Miratoi:
 Satbere Hoxha
 Administratore




Qendra Tregtare Univers Shpk
Per vitin e mbyllur ne 31 dhjetor 2016

(Vlerat ne Leke)

PASQYRA E PERFORMANCES

(Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve)

	Shenime	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit			
Te ardhurat nga aktiviteti kryesor	11	483.045.816	386.594.347
Te ardhurat nga aktivitete te tjera	12	68.535.213	99.475.877
Shpenzime te personelit	13	(2.179.394)	(2.748.801)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	6	(60.033.902)	(49.685.725)
Shpenzime te tjera shfrytezimi	14	(105.082.527)	(118.090.143)
Te ardhura te tjera		102.348	1.740
Shpenzime interesi dhe te ngjashme		(11.569.827)	(914.098)
Fitimi para tatimit		372.817.727	314.633.197
Tatimi mbi fitimin	15	(55.977.615)	(50.185.651)
Fitimi i vitit		316.840.112	264.447.546

Pasqyra e te ardhurave duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 6 deri 15 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Qendra Tregtare Univers Shpk
Per vitin e mbyllur ne 31 dhjetor 2016

(Vlerat ne Leke)

PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Fitimi i vitit	316.840.112	264.447.546
Te ardhura te tjera gjithepershireshe per vitin	-	-
Totali i te ardhurave gjithepershireshe per vitin	316.840.112	264.447.546

Pasqyra e te ardhurave gjithepershireshe duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 6 deri 15 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Qendra Tregtare Univers Shpk
Per vitin e mbyllur ne 31 dhjetor 2016

(1 Terat ne Leke)

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO

	Kapitali i nenshkruar	Rezerva ligjore	Fitimet e pashperndara	Fitimi i vitit	Totali i kapitalit
100.000	100.000				100.000
Pozicioni financiar ne 01 Janar 2015					
Te ardhurat totale gjithepërfshirëse te vitit	-	-	-	264.447.546	264.447.546
Fitim i vitit	-	-	-	264.447.546	264.447.546
Totali i te ardhurave gjithepërfshirëse per vitin					
Transaksione me pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital :					
Shtesa ne kapitalin e nënshkruar	1.110.423.000	-	-	-	1.110.423.000
Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike	1.110.423.000				1.110.423.000
Pozicioni financiar ne 31 Dhjetor 2015	1.110.523.000			264.447.546	1.374.970.546
Te ardhurat totale gjithepërfshirëse te vitit:					
Fitimi i vitit	-	-	-	316.840.112	316.840.112
Totali i te ardhurave gjithepërfshirëse per vitin					
Transaksione me pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital :					
Dividende te deklaruar	-	-	-	(264.447.546)	(264.447.546)
Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike	-	-	-	(264.447.546)	(264.447.546)
Pozicioni financiar ne 31 Dhjetor 2016	1.110.523.000			316.840.112	1.427.363.112

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 6 deri 15 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Qendra Tregtare Univers Shpk
Per vitin e mbyllur ne 31 dhjetor 2016

(Vlerat ne Leke)

PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit:		
Fitimi i vitit	316.840.112	264.447.546
<i>Rregullime per shpenzimet jo-monetare:</i>		
Shpenzime per tatimin mbi fitimin jo-monetar	(24.641.448)	42.999.826
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	60.033.902	49.685.725
<i>Ndryshimet ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit</i>		
Renie/(Rritje) ne te drejtat e arketueshme dhe te tjera	(96.398.005)	(272.984.051)
Renie/(Rritje) ne inventar	-	(127.302)
Rritje/(Renie) ne detyrimet e pagueshme	(21.146.882)	60.193.384
Mjete monetare neto nga aktivitetet e shfrytezimit	234.687.679	144.215.128
Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit		
Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(15.125.162)	(1.158.139.418)
Mjete monetare neto perdorur ne aktivitetin e investimit	(15.125.162)	(1.158.139.418)
Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e financimit		
Arketime nga emetimi i kapitalit te nenshkuar	-	1.110.423.000
Dividende te paguar pronareve te njesive ekonomike meme	(264.447.546)	-
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e financimit	(264.447.546)	1.110.423.000
Rritje/(Renie) neto ne mjetet monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare	(44.885.029)	96.498.710
Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare ne fillim	96.598.710	100.000
Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare ne fund	51.713.681	96.598.710

Pasqyra e flukseve monetare duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 6 deri 15 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare

(Vlerat ne Lek)

1 Informacion i pergjithshem

Qendra Tregtare Univers Sh.p.k (“Shoqeria”) u themelua me 11 Dhjetor 2014. Objekti i veprimtarise eshte shitje, blerje dhe dhenie me qera te pasurive te paluajtshme, ndermjetesim per blerje shitje e dhenie me qera te pasurive te paluajtshme si dhe tregeti me shumice e pakice te mallrave industrial e ushqimore.

Zyra e regjistrimit te Shoqerise eshte ne Tirane Kashar Autorstada Tirane Durres, km.7, QTU .

Numri i punonjesve te Shoqerise me 31 Dhjetor 2016 ishte 2 punonjes.

Pasqyrat financiare te shoqerise per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2016 jane miratuar nga Administratorja ne 28 Mars 2017.

2 Baza e pergatitjes

a. Bazat e pregatitjes

Pasqyrat financiare individuale jane pergatitur bazuar ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te permireshuara, te aplikueshme per pasqyrat financiare qe mbulojne periudhat duke filluar nga 1 Janar 2015.

Drejtimi i Shoqerise vlereson se Shoqeria do te vijoje aktivitetin normal tregtar per 12 muajt qe pasojne muajin e mbylljes se ketyre pasqyrave financiare. Per rrjedhoje, sipas parashikimeve te Ligjit Nr. 9228, date 29 prill 2004 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, pasqyrat financiare per vitin ushtrimor 2016 jane pergatitur ne baze te parimit te vijimesise.

Te dhenat aktuale jane te shprehura ne Lek, e cila eshte dhe monedha funksionale e shoqerise.

b. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike

c. Aktivet materiale dhe jomateriale

Aktivitet afatgjata materiale te mbajtura per investim

Aktivi afatgjatë material i investuar është pasuria (tokë ose një ndërtesë ose një pjesë e ndërtesës, apo të dyja) e mbajtur nga shoqeria për të fituar të ardhura nga qiraja ose për vlerësimin e kapitalit ose të dyja, me përjashtim të rasteve kur: (a) përdoret në prodhimin ose furnizimin e mallrave apo shërbimeve ose për qëllime administrative, ose (b) shitet në rrjedhën e zakonshme të biznesit.

Pasuria e përzier do të ndahet duke patur parasysh dy klasifikimet si aktiv afatgjatë i investuar dhe aktiv afatgjatë material. Megjithatë, nëse vlera e drejtë e aktivitet afatgjatë të investuar nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, pa kosto dhe përpjekje të panevojshme, e gjithë pasuria do të trajtohet si aktiv afatgjatë material.

(i) Matja fillestare

Në momentin e njohjes aktivitet afatgjatë të investuar maten me koston e tyre. Kostoja e aktivitet afatgjatë të blerë për t’u investuar, përfshin çmimin e blerjes dhe të gjitha shpenzimet e ngarkueshme drejtpërdrejt si tarifatat ligjore dhe të ndërmjetësimit, taksat e transferimit të pasurisë dhe kostot e tjera të transaksionit.

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare

(Vlerat ne Lek)

2 Baza e pergatitjes (vazhdim)

(ii) Vlerësimi i mëpasshëm

Aktivi afatgjatë i investuar, vlera e drejtë e të cilit të mund të matet në mënyrë të besueshme, pa kosto apo përpjekje të panevojshme, do të matet me vlerën e drejtë në çdo datë raportimi dhe ndryshimet në vlerën e drejtë njihen në fitim ose humbje. Të gjitha aktivet e tjera të investuara si toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje, për të cilat vlera e drejte nuk është e disponueshme në datën e raportimit janë mbajtur duke përdorur modelin kosto-amortizim-zhvlerësim.

(iii) Transferimet

Nëse vlera e drejtë për një zë të aktivitet afatgjatë të investuar që matet duke përdorur modelin e vlerës së drejtë, nuk është e disponueshme pa kosto ose përpjekje të panevojshme, shoqëria do ta trajtojë këtë zë si toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje deri sa vlera e drejtë të bëhet e disponueshme. Vlera kontabël e aktivitet afatgjatë të investuar në këtë datë bëhet kosto e tij. Ky është një ndryshim i rrethanave dhe jo një ndryshim në politikën kontabël.

Aktivitet afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Te gjitha aktivet afat-gjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvleresimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja perfshin shpenzime te cilat lidhen drejtperdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve te vete-ndertuara perfshin koston e materialeve dhe punes direkte, çdo kosto tjetër te lidhur drejtperdrejt me sjelljen e aktivitet ne gjendje pune per qellimin e synuar te perdorimit. si dhe kostot e çmontimit. heqjes se pjeseve dhe sjelljes si ne gjendjen e meparshme te vendndodhjes se aktivitet. Shpenzimet kapitale te aktiveve te bera gjate ndertimit kapitalizohen ne “Ndertim ne proces” dhe transferohen ne kategorie

perkatese te aktivitet kur perfundon ndertimi tij. nga kur aplikohet amortizimi perkates sipas kategorie.

Ne rastet kur pjese te nje aktivitet afatgjate material kane jetegjatesi te ndryshme. Ato kontabilizohen si zera te ndryshem (komponentet me te medhenj) te aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashte perdorimit percaktohen duke krahasuar vleren e shitjes me vleren e mbetur. dhe keto perfshihen ne pasqyren e te ardhurave.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje zeri te aktiveve afatgjata materiale njihet ne vleren kontabel te atij zeri nese eshte e mundshme qe shoqëria do te realizoje perfitime te ardhshme ekonomike nga perdorimi i pjeses zevendesuese dhe kostoja e pjeses mund te matet ne menyre te besueshme. Kostot e sherbimeve te zakonshme te aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke perdorur metoden zbritese te amortizimit, mbi jeten e vleresuar te çdo pjese te aktivitet afatgjate material duke filluar nga dita e pare e muajit qe pason muajin e blerjes. Aktivitet e marra me qira amortizohen duke marre per baze periudhen me te shkurter midis periudhes se qirase dhe jetes se dobishme te aktivitet. Toka nuk amortizohet.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen ne cdo date raportimi. Aktivitet afatgjata jomateriale njihen atehere kur eshte e mundur qe te perfitime ekonomike do te sigurohen ne te ardhmen ne lidhje me keto aktive dhe kostoja e tyre mund te matet ne menyre te besueshme. Amortizimi llogaritet duke perdorur metoden e vleres se mbetur me norme vjetore 15%.

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare

(Vlerat ne Lek)

2. Bazat e pergatitjes (vazhdim)

d. Llogarite e arketueshme dhe llogari te pagueshme

Llogarite e arketueshme njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvleresimi. Provizionit per zhvleresimin e aktiveve te arketueshme llogaritet kur ka te dhena se shoqeria nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Veshiresite financiare te debitorit, mundesia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues qe llogarite e arketueshme te zhvleresohen. Shuma e provizionit llogaritet si diference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Llogarite e pagueshme paraqiten me vleren e tyre te drejte dhe me pas me kosto te amortizuar, duke perdorur metoden e interesit efektiv.

e. Paraja dhe ekuivalentet e parase

Paraja dhe ekuivalentet e parase perfshijne arken, llogarite rrjedhese dhe depozitat ne te pare me bankat ne Lek dhe ne monedha te huaja. Per qellimin e pasqyres se flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj perfshijne depozita pa afat ose me nje maturim prej tre muajsh ose me pak qe nga data e fillimit.

f. Transaksione ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e bilancit. Fitimi ose humbja nga kembimi ne zera monetare eshte diferenca qe vjen nga kembimi i nje numri te caktuar njesish te nje monedhe te huaj ne monedhen funksionale me kurse te ndryshme kembimi ne datat e kembimit. Te drejtat dhe detyrimet jo-monetare si dhe parapagimet ne lidhje me AAM per t'u blere ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit ndersa ato qe maten me vlere te drejte rikembepen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates kur eshte percaktuar vlera e drejte. Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare te kembimit per monedhat kryesore te perdorura ne konvertimin e zerave te bilancit ne monedhe te huaj ishin si me poshte (ne Lek):

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
1 EUR	135,23	137,28
1 USD	128,17	125,79

f. Te ardhurat

Te ardhurat njihen ne masen qe eshte e mundshme qe perfitimet e ardhshme ekonomike do ti vijne kompanise dhe keto perfitime mund te maten ne menyre te besueshme. Shpenzimet njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur ato kryhen. Te ardhurat dhe shpenzimet regjistrohen ne pasqyrat financiare te periudhes te ciles i perkasin.

Qendra Tregtare Univers Shpk
Per vitin e mbyllur ne 31 dhjetor 2016

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare

(Vlerat ne Lek)

2. Bazat e pergatitjes (vazhdim)

g. Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin eshte llogaritur ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per tatimin mbi fitimin per periudhen e mbyllur me 31 Dhjetor 2016. Tatimi mbi fitimin perfshin teresisht tatimin mbi fitimin e llogaritur per periudhen kontabel. Tatimi aktual mbi fitimin llogaritet si 15% e fitimit te tatueshem te percaktuar ne legjislacionin e kontabilitetit dhe legjislacionin tatimor ne Shqiperi per vitin 2016.

Tatimet e shtyra njihen duke perdorur metoden e bilancit duke marre parasysh diferencat e ne kohe midis tepricave te aktiveve dhe detyrimeve per raportimin ne pasqyrat financiare me vlerat e njohura per efekt tatimi fitimi. Tatimet e shtyra maten duke perdorur normen e tatim fitimit qe pritet te perdoret per diferencat ne kohe kur ato te rimerren bazuar ne ligjet qe jane miratuar ne daten e raportimit. Tatimet e shtyra aktive njihen deri ne masen e mundesise qe fitime te ardhshme tatimore do te jene te disponueshme qe diferencat ne kohe te perdoren. Tatimet e shtyra jane rregjistruar si korrigjim i detyrimit/(rimbursimit) per tatim fitimi.

h. Krahasueshmeria

Informacioni krahasues paraqitet ne menyre te vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabel te Shoqerise dhe duke u bazuar ne modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kontabel Shqiptar.

i. Biznesi ne vijimesi

Te dhenat e kontabilitetit jane mbajtur duke qene ne perputhje me parimet e pergjithshme te kontabilitetit, ne menyre te vecante me bazen e matjes me kosto historike, parimin e kontabilitetit rrjedhes, konceptin e kujdesit dhe me supozimin e biznesit ne vijimesi.

Pasqyrat financiare jane pergatitur sipas parimit te vijimesise, i cili parashikon realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve gjate ecurise normale te biznesit.

3 Mjete monetare

Mjete monetare dhe ekuivalente me to perbehet si me poshte:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Vlera në arkë	248.712	3.610.091
Vlera në banka	51.464.969	92.988.619
<i>Ne Lek</i>	<i>35.539.837</i>	<i>39.297.780</i>
<i>Ne Euro</i>	<i>15.925.132</i>	<i>53.690.839</i>
Totali	51.713.681	96.598.710

Qendra Tregtare Univers Shpk
Per vitin e mbyllur ne 31 dhjetor 2016

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare

(Vlerat ne Lek)

4 Te drejta te arketueshme

Te drejta te arketueshme perbehet te drejta te arketueshme per sherbimet e kryera klienteve si me poshte:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Kliente	20.886.133	2.422.961
Totali	20.886.133	2.422.961

5 Te tjera te arketueshme

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
TVSH e arketueshme, neto	2.592	-
Te tjera te arketueshme nga palet e lidhura	266.665.724	212.143.754
Totali	266.668.316	212.143.754

TVSH e (arketueshme)/ pagueshme, neto

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
TVSH e pagueshme mbartur nga viti paraardhes	19.876	
TVSH e llogaritur (rubrika 12)	12.190.287	12.704.791
TVSH i zbritshem blerje (rubrika 17)	(11.623.219)	(11.672.619)
TVSH e paguar gjate vitit ushtrimor	(589.536)	(1.012.298)
TVSH e (arketueshme)/ pagueshme, neto	(2.592)	19.874

Qendra Tregtare Univers Shpk
Per vitin e mbyllur ne 31 dhjetor 2016

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare
(Vlerat ne Lek)

6 Aktive afatgjata materiale te mbajtura per investim

Kosto	Toka	Ndertesa	Impiante dhe makineri	Te tjera instalime dhe pajisje	Parapagime per aktive materiale dhe ne proces	Te tjera	Totali
Me 01 Janar 2015	-	-	-	-	-	-	-
Shtesa	32.200.000	1.078.223.000	15.198.828	735.920	20.812.037	10.969.633	1.158.139.418
Transferime	-	16.131.652	3.796.560	-	(19.928.212)	-	-
Me 31 Dhjetor 2015	32.200.000	1.094.354.652	18.995.388	735.920	883.825	10.969.633	1.158.139.418
Shtesa	-	-	12.827.327	-	2.297.836	-	15.125.163
Transferime	-	-	2.351.920	-	(2.351.920)	-	-
Me 31 Dhjetor 2016	32.200.000	1.094.354.652	34.174.635	735.920	829.741	10.969.633	1.173.264.581
Amortizimi i akumuluar							
Me 01 Janar 2015	-	-	-	-	-	-	-
Amortizimi per vitin	-	(49.418.554)	(267.171)	-	-	-	(49.685.725)
Me 31 Dhjetor 2015	-	(49.418.554)	(267.171)	-	-	-	(49.685.725)
Amortizimi per vitin	-	(52.246.805)	(5.445.987)	(147.184)	-	(2.193.927)	(60.033.903)
Me 31 Dhjetor 2016	-	(101.665.359)	(5.713.158)	(147.184)	-	(2.193.927)	(109.719.628)
Vlera kontabel neto:							
Me 01 Janar 2015	-	-	-	-	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2015	32.200.000	1.044.936.098	18.728.217	735.920	883.825	10.969.633	1.108.453.693
Me 31 Dhjetor 2016	32.200.000	992.689.293	28.461.477	588.736	829.741	8.775.706	1.063.544.953

Qendra Tregtare Univers Shpk
Per vitin e mbyllur ne 31 dhjetor 2016

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare

(Vlerat ne Lek)

6 Aktive afatgjata materiale te mbajtura per investim (vazhdim)

Aktivet afatgjatë materiale te mbajtura per investim perfaqesojne toka dhe ndertesa te qendres tregtare QTU qe mbahen për të fituar të ardhura nga qiraja. Ne fund te vitit financiar vlera e drejtë e ketyre aktiveve nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, pa kosto apo përpjekje të panevojshme. Ne keto kushte shoqeria ka vendosur qe aktivet e investuara per te cilat vlera e drejte nuk eshte e disponueshme ne daten e raportimit te mbahen duke përdorur modelin kosto-amortizim-zhvlerësim.

7 Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore shendetesore

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Te pagueshme ndaj punonjesve	-	-
Sigurime shoqerore dhe shendetesore te pagueshme	23.278	51.448
Totali	23.278	51.448

8 Te pagueshme per detyrime tatimore

Te pagueshme per detyrime tatimore perbehet si me poshtë:

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2016	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2015
TVSH e pagueshme, neto	-	19.876
Tatim fitimi i pagueshem	18.358.378	42.999.826
Taksa dhe tatime te tjera	264.090	269.431
Totali	18.622.468	43.289.133

9 Arketime ne avance per porosi

Arketime ne avance per porosi perfshin garanci te marra ne avance per qera.

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2016	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2015
Garanci te marra	6.524.122	4.602.085
Totali	6.524.122	4.602.085

Qendra Tregtare Univers Shpk
Per vitin e mbyllur ne 31 dhjetor 2016

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare

(Vlerat ne Lek)

10 Kapitali i nenshkuar

Kapitali i nenshkuar me 31 Dhjetor 2016 eshte 100.000 Lek ne para dhe 1.110.423.000 Lek ne natyre i ndare ne 1 kuote me vlere 1.110.523.000 Lek. Ne 31 Dhjetor 2016 MANETCI ka nje pjesemarrje 100%.

11 Te ardhura nga aktiviteti kryesor

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2016	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2015
Te ardhura nga qerate	483.045.816	363.692.642
Te ardhura nga marketing	-	22.901.705
Totali	483.045.816	386.594.347

12 Te ardhura nga aktivite te tjera

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2016	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2015
Te ardhura nga shpenzime operative	63.313.173	65.461.035
Te tjera	5.222.040	34.014.842
Totali	68.535.213	99.475.877

13 Shpenzime te personelit

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2016	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2015
Pagat	1.895.108	2.401.101
Sigurimet shoqerore	284.286	347.700
Totali	2.179.394	2.748.801

Qendra Tregtare Univers Shpk
Per vitin e mbyllur ne 31 dhjetor 2016

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare

(Vlerat ne Lek)

14 Shpenzime te tjera te shfrytezimit

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2016	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2015
Uje, drita	59.317.195	58.757.249
Qira	28.400.820	24.607.030
Taksa dhe tarifa vendore	12.395.420	5.791.120
Publicitet dhe reklama	1.624.350	2.110.760
Mirembajtje dhe riparime	477.226	2.150.455
Shpenzime bankare	433.104	125.666
Sherbime profesionale	416.800	539.311
Gjoha dhe demshperblime	59.251	150.247
Shpenzime te tjera operative	1.958.361	23.858.305
Totali	105.082.527	118.090.143

15 Tatimi mbi fitimin

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2016	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2015
Shpenzimi per tatimin mbi fitimin	55.977.615	50.185.651
Tatim fitimi i shtyre	-	-
Totali	55.977.615	50.185.651

	Norma efektive e tatimit	31 Dhjetor 2016	Norma efektive e tatimit	31 Dhjetor 2015
Fitimi para tatimit		372.817.727		314.633.197
Tatimi fillestar me 15%	15%	55.922.659	15%	47.194.980
Efekti tatimor i te ardhurave qe nuk jane te zbritshme per qellime tatimore		-		-
Efekti tatimor i shpenzimeve qe nuk jane te zbritshme per qellime tatimore	0,01%	54.956	0,95%	2.990.671
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	15%	55.977.615	16%	50.185.651
		31 Dhjetor 2016		31 Dhjetor 2015
Fitimi para tatimit		372.817.727		314.633.197
Shpenzime te pa-zbritshme		366.373		19.937.809
Fitimi i tatueshem		373.184.100		334.571.006

Qendra Tregtare Univers Shpk
Per vitin e mbyllur ne 31 dhjetor 2016

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare

(Vlerat ne Lek)

16 Ngjarje pas dates se raportimit

Politika kontabile e shoqërisë, sic eshte paraqitur ne shënimin 6 me sipër, eshte qe te paraqesi te gjitha aktivet afat-gjata materiale te mbajtura per investim me kosto duke zbritur zhvleresimin dhe amortizimin e akumuluar. Megjithate, ne Janar te vitit 2017 Shoqeria ka angazhuar Colliers International, nje vlerësues i pavarur, per te kryer rivlerësimin e pronës te Qendres Tregtare Univers (QTU) mbi Bazen e Vleres se Tregut ne 31 Dhjetor 2015. Prona përfshin te gjitha ambientet brenda hapësirave dhe rrethimit te QTU. Raporti përfundimtar i vlerësuesit te pavarur date 09 Janar 2017 ka arritur ne konkluzionin se Vlera e Tregut eshte 16.800.000 Eur. Shoqeria do te trajtoje disponueshmerine e vleres se drejte si ndryshim te rrethanave dhe do te njohe rivlerësimin ne vitin 2017, ne momentin kur ka paguar taksen e rivlerësimit. Nese ky rivlerësim do ishte njohur ne pasqyrat e vitit 2016 atehere aktivet afatgjata dhe fitimi para tatimit do te rriteshin me nje vlere 1.206.866.306 Lek.

Ne baze te ligjit Nr. 81/2016 “Per Rivleresimin e Pasurive te Paluajtshme” pagesa 3% të diferencës ndërmjet vlerës së rivlerësimit dhe vlerës kontabël të regjistruar ne 31 Dhjetor 2015, me nje vlere 36.205.989 Lek për pasuritë e paluajtshme eshte paguar ne 24 Janar 2017.